



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 5349

Tirane, date 31.07.2015

Drejtuar: Z.ALFRED MERAJ
SHOQERIA "GEZIMI XX" SH.P.K
FSHATI KRASTE

KRUJE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.841 date 26.01.2005.

I nderuar zoti Meraj,

Shoqëria "Gëzimi XX" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.841 date 26.01.2005, për gurë gëlqeror, ne fshatin Kraste, Kruje, ne Qarkun Durrës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 1968 date 06.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.922 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.841 date 26.01.2005, për gurë gëlqeror, ne fshatin Kraste, Kruje, ne Qarkun Durrës, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2013-2014 dhe vitin 2014-2015.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gërmen “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në zbatim të pikës 6 të nenit 24 duhet të kishit aplikuar për një shtesë të afatit të vlefshmërisë së lejes edhe për 10 vite të tjera 180 ditë para se afati fillestar i vlefshmërisë së saj të përfundonte, i cili ka qenë datë 26.01.2015

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.841 datë 26.01.2005, për gurë gëlqeror, në fshatin Kraste, Krujë, në Qarkun Durrës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.841 datë 26.01.2005.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKURI

